



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1432/2022

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINE– Dhoma e Shkallës së Dytë, e përbërë nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësllësi Prishtina sh.a me seli në Prishtinë, rruga Hazir Shala nr.4 kundër të debitorit R.Sh. .... Taxi rruga .... nga Prishtina, të cilën e përfaqëson me autorizim zyra ligjore Arche Lex shpk në Prishtinë, sheshi .... 23/7, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.272/2021 të datës 28.09.2021, jashtë seancës me datën 15.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË si e palejuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësllësi Prishtina sh.a me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.272/2021 të datës 28.09.2021

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin e ankimuar ka vendosur si në dispozitiv I. Pranohet si pjesërisht si i bazuar prapësimin e debitorit R.Sh. .... Taxi rruga .... në Prishtinë, dhe Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.130/21 dt.25.01.2021 Shfuqizohet për shumën prej 1,120.89€ për shkak të parashkrimit të kërkesës për periudhën 31.12.2013 deri 31.12.2017, II. Refuzohet si e pabazuar pjesë tjetër e prapësimit të debitorit i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.130/21 dt.25.01.2021 i lejuar nga zyra përmbartimore e përmbartuesit privat Valdrin Beka në Prishtinë për shumën prej 526.58€ për periudhën 31.01.2018 deri 31.01.2021, III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, urdhërohet që në afat prej 7 ditësh të paguaj garancionin në gjykatë në shumën prej 526.58€, IV. në qoftëse pala ankuese dështon të paguaj shumën e garancisë së caktuar nga gjykata, brenda afatit si në pikën III te dispozitivit, ankesa e parashtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare nga pala ankuese.

Kundër Aktvendimit PPP.nr.272/21 dt.28.09.2021, kreditori ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar, ose ta ndryshoj aktvendimin e kundërshtuar. Gjykata nuk i ka trajtuar fare pretendimet e kreditorit që ka ndërprerje të parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së, për më tepër gjykata konstaton në mënyrë të gabuar dhe jo të drejt gjendjen faktike, sepse në vazhdimësi ka bërë pagesa ndaj kreditorit dhe nuk është fjale për një pagesë për dhjetëra pagesa në shuma të ndryshme të njëpasnjëshme nga viti 2013 e deri 2021. Gjykata gabimisht ka interpretuar parashkrimin sepse debitori deri me 31.05.2018 borxhin e ka pas të ri programuar me këste dhe atë në vlerë prej 7.41€ pra nuk qëndron konstatimi i gjykatës së është parashkru borxhi, nuk është i besueshëm kur ka arsyetuar sepse debitori me dt.25.01.2021 ka parashtruar propozim ndërsa debitori deri me 31.05.2018 e ka pas borxhin e ri programuar sipas kontratës.

Përgjigje në ankesë nuk ka në shkresat e lëndës.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 22.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të ekstraktit nga librat e kontabilitetit.

Përmbartuesi Privat Valdrin Beka në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.130/21 dt.25.01.2021, ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm ekstrakti i verifikuar nga librat e kontabilitetit nr.L80459.

Gjykata e shkallës e parë me Aktvendimin PPP.nr.272/2021 të datës 28.09.2021 ka vendosur si në dispozitiv të vendimit, me arsyetimin se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesërishëm të kërkesës së kreditorit në pajtim me nenin 253 par.1 të LMD, për periudhën prej datës 31.12.2013 e deri 31.01.2018 në shumën e përgjithshme prej 1,120.89€, pasi që propozimi për përmbartim të përmbartuesi privat është parashtruar me datë 22.01.2021. Po ashtu kjo gjykatë me aktvendimin PPP.nr.272/2021 të datës 28.09.2021 ka caktuar garancionin në të holla në shumën prej 526.58€, si parakusht për parashtrimin e ankesës kundër aktvendimit PPP.nr.272/2021 të datës 28.09.2021, dhe ka paralajmëruar se në qoftëse pala ankuuese dështon që ta paguaj shumën e garancisë brenda afatit si në pikën III të dispozitivit, do të konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare kundër këtij aktvendimi. Kjo gjykatë arsyetoi se neni 78 par.4 të LPP përcakton se nëse garancioni nuk paguhet atëherë konsiderohet se nuk është dorëzuar fare ankesa nga pala ankuuese në këtë rast debitori.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se me të drejt gjykata e shkallës së parë, ka obliguar palët ankuese të paguaj garancionin bankar si parakusht për ankesën, duke u referuar në dispozitën ligjore nga neni 78 paragrafi 1 të LPP-së, që parasheh: se *“Gjykata e shkallës së parë, në rastet kur debitori dëshiron të parashtrij ankesë kundër vendimit me të cilin është refuzuar prapësimi i tij në lidhje me propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, urdhëron palën ankuese që të paguaj garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dëm të riparueshëm palës ankuese dhe nëse dëmi është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë”*.

Në rastin konkret nga shkresat në lëndë, Dhoma e shkallës së dytë, nuk ka gjetur dëshmi se kreditori ka deponuar garancionin në llogari të KGJK-së, siç urdhëron Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr.272/21 dt.28.09.2021, apo ka bërë kërkesë për lirim nga pagesa e garancisë nga shkaqet e cekura si në dispozitën e nenit 78 paragrafi 2 i LPP-së. Andaj bazuar në nenin 78 par.4 të LPP ku përcaktohet se *“nëse pala ankuese dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese”*, Dhoma e shkallës së dytë vlerësoi se nuk mund të shqyrtohen pretendimet ankimore të kreditorit, për arsye se ligjvënësi një rast të tillë e ka konsideruar sikurse nuk është paraqitur fare ankesa nga ana e debitorit.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1432/22 me datë 15.11.2022

Gjyqtari,  
Krenar Berisha